

ANALIZË POLITIKASH

POLITIKAT E **TAKSIMIT** TË KARBONIT

RËNDËSIA, SFIDAT DHE MUNDËSITË
PËR KOSOVËN





ANALIZË POLITIKASH

POLITIKAT E TAKSIMIT TË KARBONIT

RËNDËSIA, SFIDAT DHE MUNDËSITË
PËR KOSOVËN



Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), në kuadër të projektit “Taksa në Karbon – Avokim për implementimin e sistemit të brendshëm të tatimit të karbonit në politikat e Kosovës” ka hartuar punimin “Politikat e Taksimit të Karbonit – Rëndësia, Sfidat dhe Mundësitë për Kosovën”. Ky punim është hartuar në kuadër të programit të Zhvillimit të Qëndrueshëm të INDEP. Projekti është i mbështetur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, andaj pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të INDEP dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen si qëndrim i Fondacionit Kosovarë për Shoqëri të Hapur.

Autori: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillimi i Qëndrueshëm**

Publikuar: **Qershor 2022**

PËRMBAJTJA

Hyrje	7
Metodologjia	9
1. Ndryshimet klimatike dhe Rëndësia e Çmimit në Karbon	12
2. Rugët e Vendosijes së çmimit në Karbon	16
2.1 Taksa e Karbonit kundrejt Sistemit të Tregtimit të Emetimeve (STE)	17
2.2 Taksa e Karbonit	18
2.3 Sistemi i Tregtimit të Emetimeve	19
3. Politikat e Bashkimit European për Çmimin në Karbon	20
3.1 Sistemi i Tregtimit të Emetimeve i BE	21
3.2 Direktiva e Taksimit të Energjisë	23
3.3 Mekanizmi i Rregullimit Kufitar të Karbonit	25
4. Implementimi i Taksës së Karbonit	26
4.1 Taksapaguesit	30
4.2 Normat e Taksimit	31
4.3 Administrimi i Taksës	36
4.4 Përdorimi i të ardhurave	39
5. Efekti i Taksës së Karbonit sipas Sektorëve	40
5.1 Sektori i Energjisë	41
5.2 Transporti	43
5.3 Sektori i Industrisë	45
5.4 Amvisëria	46
6. Shtetet që kanë implementuar Taksën e Karbonit	48
Përfundime	51
Rekomandime	53



HYRJE

Pas tejkalimit të një sfide globale dhe kërcënuese si pandemia COVID-19, bota ka shumë gjasa të përballet me sfidën e shekullit, luftimin e ndryshimeve klimatike. Shkencëtarët ia atribuojnë trendin e ngrohjes globale të vërejtur që nga mesi i shekullit të 20-të, zgjerimit njerëzor të "efektit serë" që rezulton kur atmosfera bllokoi nxehtësinë që rrezatohet nga Toka në drejtim të hapësirës. Njerëzit kanë rritur përqendrimin e CO₂ në atmosferë me 48% që nga fillimi i Revolucionit Industrial. Megjithëse emetimet e gazeve serrë janë ulur ndjeshëm gjatë periudhës së karantinës për shkak të lëvizjes së kufizuar, me heqjen e kufizimeve të COVID dhe kthimin e aktivitetit normal, këto emetime janë rritur dhe pritet të tejkalojnë vlerat e mëparshme. Në këtë aspekt kërkohen ndryshime të konsiderueshme politikash në nivel global për të ndihmuar në zbutjen e këtyre efekteve duke reduktuar emetimet e karbonit.

Ndërsa Kosova synon të integrohet në Bashkimin Evropian, fokusi i Bashkimit Evropian është zhvendosur në miratimin e politikave dhe vendosjen e synimeve ndërkombëtare për të luftuar ndryshimet klimatike. Janë hartuar politika dhe marrëveshje ndërmjet vendeve evropiane dhe vendeve të treta në përpjekje për të zbutur efektet e ndryshimeve klimatike. Kosova si vend në zhvillim nuk e ka priorizuar këtë çështje, pasi zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale kanë qenë gjithmonë fokusi kryesor i qeverive. Por qëndrueshmëria dhe zhvillimi ekonomik mund të bashkëjetojnë, me politika të përshtatshme.

Kosova ka nënshkruar Deklaratën e Samitit të Sofjes dhe është zotuar për dekarbonizimin e plotë deri në vitin 2050. Synimi për dekarbonizim të plotë deri në vitin 2050 është një synim ambicioz dhe mund të arrihet vetëm duke vendosur politika praktike për reduktimin e emetimeve sa më shpejt të jetë e mundur. Çmimi i karbonit është një mjet politikash që vendos një çmim drejtpërdrejt në emetimin e gazeve serrë, duke motivuar kështu kompanitë të investojnë në teknologji më të pastër ose të kalojnë në praktika më efikase, duke siguruar një ulje të CO₂. Kur emetimet e gazrave serrë janë më të shtrenjta, aktorët ekonomikë nxiten të llogarisin kostot e emetimeve të tyre kur marrin vendime tregtare. Me kalimin e kohës, këto kosto do të nënkuptojnë që prodhuesit me emetime më të ulëta fitojnë treg më shumë kundrejt konkurrentëve të tyre me emetime më të larta. Në të njëjtën kohë, konsumatorët do të zhvendosen drejt produkteve me emetim më të ulët për shkak të avantazhit të tyre në kosto, ndërsa konsumi i produkteve me emetim më të lartë do të reduktohet ose të shmanget. Vendosja e një çmimi për karbonin është miratuar nga shumë vende si mënyra më efikase për të reduktuar emetimet e gazrave serë.

Çmimi në karbon është një politikë që Kosova nuk mund ta shmangë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian në të ardhmen. Prandaj, sipas draftit të Strategjisë së re të Energjisë 2022-2031, një formë e çmimit të karbonit, më saktësisht taksa e karbonit është paraparë të hyjë në fuqi në Kosovë nga viti 2025. Kjo taksë do të mbulojë sektorin më ndotës në Kosovë, atë të energji. Megjithatë, në vitet në vijim institucionet e vendit tonë duhet të parashikojnë zgjerimin e mbulimit nga taksa e karbonit për të arritur dekarbonizimin e të gjithë sektorëve që varen nga djegia e lëndëve djegëse fosile. Duke pasur parasysh se Bashkimi Evropian tashmë ka një sistem të çmimeve të karbonit që mbulon sektorin e energjisë dhe po propozon zgjerimin e mbulimit, Kosova duhet të ndjekë hapat e BE-së me qëllim

që të përmbushen qëllimet e reduktimit të emetimeve.

Që nga prilli 2021, 45 juridiksione kombëtare dhe 34 ndërkombëtare po vendosin një çmim për karbonin me më shumë vende duke planifikuarë zbatimin e çmimit në karbon në të ardhmen. Numri i vendeve që do të zbatojnë Çmimet e Karbonit në vitet e ardhshme vetëm do të rritet, për të arritur dekarbonizimin e sektorëve të energjisë, transportit dhe industrisë. Ky tranzicion do të jetë jashtëzakonisht sfidues për vendet në zhvillim si Kosova, të cilat ende varen nga burimet shumë ndotëse të energjisë siç është linjiti. Prandaj Kosova duhet ta zbatojë një politikë të tillë sa më parë që të fillojë ky tranzicion i pashmangshëm.

Me zhvillimet e fundit në sektorin e energjisë dhe sigurinë ushqimore që nga pushtimi i Ukrainës, rëndësia e një tranzicioni të gjelbër nuk ka qenë kurrë më e qartë. Megjithëse çmimi i karbonit është mjeti më efektiv për të rritur investimet për tu larguar nga teknologjitë ndotëse, shumë vende hezitojnë ta përvetsojnë këtë politikë nga frika e humbjes së konkurrencës ndërkombëtare. Kjo është arsyeja pse Fondi Monetar Ndërkombëtar ka propozuar një bazë të çmimit ndërkombëtar të karbonit (International Carbon Price Floor) të vendosur në 25 dollarë për vendet me të ardhura të ulëta, 50 dollarë për vendet me të ardhura mesatare dhe 75 dollarë për vendet me të ardhura të larta, ku vendet duhet të paktën të arrijnë të njëjtën ulje të emetimeve sa niveli bazë i çmimit të karbonit. Kjo do të ndihmonte në uljen e emetimeve për të arritur objektivin nën 2 gradë, dhe gjithashtu nëse vendet investojnë në teknologji të pastër, vendosja e një çmimi të karbonit do të kishte një ndikim shumë të vogël në rritjen ekonomike.

Duke mos vepruar ne rrisim rrezikun e fatkeqësive. Vonimi i veprimit tani, rrezikon rritjen e kostove në tranzicionin në industri dhe praktika neutrale ndaj karbonit. Kosova duhet t'i japë prioritet investimeve në burime të pastra dhe të subvencionojë / stimulojë ose lehtësojë investimet për industrinë që kontribuojnë në investimet dhe efikasitetin e BRE. Investimi në një ekonomi me ndotje karboni do të sjellë humbje financiare pasi buxhetet e karbonit do të shtrëngohen në të ardhmen. Nga ana tjetër, me rritjen e taksave, të ardhurat nga kjo taksë do të kthehen në një pasuri për vendin.

Me rritjen progresive të taksës së karbonit, Kosova do të ketë të ardhura që mund të alokohen në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe administrim më efikas tatimor. Vendet mund të përqendrohen në adresimin e drejtpërdrejtë të pasojave të padëshiruara të shpërndarjes, nëpërmjet ofrimit të kompensimeve (p.sh. norma më të ulëta të TVSH-së, ulje të taksave) për të ndihmuar familjet e cenueshme dhe sektorët industrialë; dhe/ose t'i jepet përparësi eksternaliteteve "pozitive", duke vendosur kushte që mundësojnë që subjektet emetuese të rrisin fleksibilitetin e tyre dhe të përshtaten më lehtë me çmimin e karbonit. Shpërndarja e të ardhurave nga çmimi i karbonit është një faktor kyç në pranueshmërinë e taksave dhe administrimin e taksave. Prandaj Kosova ka një rrugë shumë sfiduese përpara dhe me politikat e duhura do të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe mirëqenie të përgjithshme.

'NE DUHET TË VENDOSIM NJË ÇMIM NË KARBON, SEPSE VEÇSE KA NJË ÇMIM NË KARBON, JANË PASOJAT PËR SHËNDETIN, EKONOMINË DHE KLIMËN TONË'.¹

¹Jerry Brown, Governor of California accessible at <https://youtu.be/5fvdD0Ev7eU> (accessed in March, 2022)

METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur për hartimin e këtij punimi ka qenë kuantitative dhe kualitative. Në pjesën e hulumtimit kuantitativ kemi shfrytëzuar të dhënat nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës, Ministria e Ekonomisë dhe kompania Eurosteel. Të dhënat kuantitative u plotësuan nga intervista gjysmë të strukturuar nga hulumtimi në zyrë.

Gjithashtu analizuam përmbajtjen e të dhënave dhe informacionit të marrë nga raportet e ndryshme, legjislacioni në fuqi, legjislacioni i huaj, direktivat evropiane, studimet krahasuese dhe rregulloret e ndryshme. Ne i kemi kategorizuar këto të dhëna në disa kategori për analizë dhe kemi nxjerrë përfundimet tona prej tyre.

Në pjesën e kërkimit kuantitativ ne kemi realizuar tre intervista. Përgjigjet nga intervistat janë sistemuar në një dokument excel ku analizohen përgjigjet e secilit aktor duke identifikuar trende dhe përgjigje të shpeshta nëpër kategori të ndryshme si sfida apo mundësi. Në fund, raporti i hulumtimit është shkruar duke marrë parasysh rregullat e shkrimit akademik. Krahas analizës së përmbajtjes, para hartimit të përfundimeve dhe rekomandimeve të punimit është bërë një analizë kontekstuale.

Procesi i përzgjedhjes së rasteve u drejtua nga kërkimi i përgjigjeve, zgjidhjeve dhe praktikave më të mira në botë. Me këtë në mendje, çdo rast u strukturua për të dhënë një mësim, një praktikë të mirë, ose ndoshta një rrugë drejt vendosjes së një takse karboni dhe çmimi të karbonit. Megjithatë, jo të gjitha mësimet praktike të nxjerra janë të zbatueshme në rastin e Kosovës, veçanërisht pasi vendet ndryshojnë në aspektin e aftësive teknike; qëllimit të projektit, ekspertizës dhe financimit. Vendet që janë mbuluar gjerësisht janë Shqipëria, Estonia, Polonia, Sllovenia dhe Suedia.



CILESIA

METODOLOGJIA

SASIA





NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE RËNDËSIA E ÇMIMIT NË KARBON

1



“Efekti serë” është ngrohja që ndodh kur disa gazra në atmosferën e Tokës bllokojnë nxehtësinë. Këto gazra lejojnë dritën të hyjë, por nuk lejojnë që nxehtësia të dalë, si muret e qelqit të një sere, prej nga vjen emri. Drita e diellit rrezaton në sipërfaqen e Tokës, ku energjia absorbohet dhe më pas reflektohet përsëri në atmosferë si nxehtësi. Në atmosferë, molekulat e gazit serrë ndalin një pjesë të nxehtësisë, dhe pjesa tjetër lirohet në hapësirë. Me rritjen e përqendrimit të këtyre gazeve në atmosferë, rritet edhe temperatura e tokës në përgjithësi dhe kjo shkakton ndryshime në klimën tonë në një periudhë më të shkurtër kohore, krahasuar me ndryshimet natyrore.

EMETIMET GLOBALE TË CO₂ NGA LËNDËT DJEGËSE FOSILE




Figura 1. Emetimet Globale të CO₂ nga lëndët djegëse fosile²

Stabiliteti afatgjatë i klimës varet nga bilanci i rrezatimit të Tokës. Emetimet natyrore mbahen të balancuara sepse proceset që gjenerojnë emetime të CO₂ (si frymëmarrja e njerëzve dhe kafshëve dhe dekompozimi) kompensohen nga proceset e kapjes së emetimeve, duke përfshirë fotosintezën dhe emetimet e absorbuara nga oqeani. Emetimet e gazeve serrë, veçanërisht emetimet e karbonit që vijnë nga djegia e lëndëve djegëse fosile, janë nxitësit kryesorë të ndryshimeve klimatike dhe kanë një sërë pasojash të tjera shëndetësore dhe mjedisore. Edhe nëse do të ndalonim të gjitha emetimet sot, do të duheshin ende deri në 200 vjet që grimca e fundit CO₂ e emetuar artificialisht të largohej nga atmosfera.

² shorturl.at/lpDFO, (accessed in February, 2022)

“Efekti serë” është ngrohja që ndodh kur disa gazra në atmosferën e Tokës bllokojnë nxehtësinë. Këto gazra lejojnë dritën të hyjë, por nuk lejojnë që nxehtësia të dalë, si muret e qelqit të një sere, prej nga vjen emri. Drita e diellit rrezaton në sipërfaqen e Tokës, ku energjia absorbohet dhe më pas reflektohet përsëri në atmosferë si nxehtësi. Në atmosferë, molekulat e gazit serrë ndalin një pjesë të nxehtësisë, dhe pjesa tjetër lirohet në hapësirë. Me rritjen e përqendrimit të këtyre gazeve në atmosferë, rritet edhe temperatura e tokës në përgjithësi dhe kjo shkakton ndryshime në klimën tonë në një periudhë më të shkurtër kohore, krahasuar me ndryshimet natyrore.




Figura 2. Infografiku i Gjurmës së Karbonit





Figura 3. Emisionet në Kosovë në vitin 2018 për ndotësit kryesorë sipas sektorëve [mg / vit]³

Një nga mënyrat më efektive për të kufizuar dhe mundësisht reduktuar emetimet e gazeve serrë është vendosja e një çmimi për burimet e këtyre emetimeve. Çmimi në karbon është një nga instrumentet më të forta të politikave në dispozicion për luftimin e ndryshimeve klimatike. Ajo ka potencialin për të dekarbonizuar aktivitetin ekonomik të botës duke ndryshuar sjelljen e konsumatorëve, bizneseve dhe investitorëve, ndërkohë që i hap dyert inovacionit teknologjik dhe gjeneron të ardhura që mund të kenë përdorim produktiv. Me pak fjalë, çmimi në karbon i dizajnuar mirë ofron përfitime të trefishta: mbron mjedisin, nxitë investimet në teknologji të pastra dhe rritë të ardhurat. Shumë vende në botë tashmë i kanë miratuar këto politika, dhe shumë vende të tjera po shqyrtojnë forma të ndryshme të çmimit në karbon, prandaj Kosova duhet të ndjekë shembullin e vendeve të rajonit dhe vendeve evropiane në mënyrë që të luftojmë bashkërisht këtë krizë klimatike dhe gjithashtu të jetë një candidate e denjë për integrim në Bashkimin Evropian.

³ Përmbledhje jo-teknike e inventarit të emisioneve në Kosovë, Kosovo Environment Protection Agency, (accessed in April, 2022)Përmbledhje jo-teknike e inventarit të emisioneve në Kosovë, Kosovo Environment Protection Agency, (accessed in April, 2022)

RRUGËT E VENDOSJES SË ÇMIMIT NË KARBON

2



Në përgjithësi, qeveritë që planifikojnë të zbatojnë çmimin e karbonit mund të marrin dy qasje politikash për të reduktuar emetimet e karbonit. Së pari, qasjet rregullatore, shpesh të njohura si instrumente të politikës “komandim dhe kontroll”, që mbështeten në futjen e rregulloreve specifike për të ndryshuar praktikën. Këto qasje përfshijnë standardet e emetimeve, kërkesat e raportimit dhe licencimin e emetimeve, ndër të tjera. Një qasje e dytë mund të jetë çmimi i karbonit. Të dy llojet e instrumenteve janë efektive në reduktimin e ndotjes, por ka prova të konsiderueshme që çmimi i karbonit e bën këtë me një kosto më të ulët.⁴ Prandaj, shumica e vendeve në zhvillim kanë miratuar çmimin e karbonit si një politikë më të lehtë për t’u menaxhuar.

2.1 TAKSA E KARBONIT KUNDREJT SISTEMIT TË TREGTIMIT TË EMETIMEVE (STE)

Çmimi i karbonit mund të paraqitet në dy forma të ndryshme, taksimi i karbonit ose sistemi i tregtimit të emetimeve. Taksimi i karbonit është një instrument politikash ku një qeveri vendos çmimin e karbonit dhe lejon që tregu të përcaktojë emetimet totale. Një STE është një instrument çmimi ku qeveria vendos një kufi maksimal për emetimet dhe lejon tregun të përcaktojë çmimin e emetimeve të karbonit dhe përpjekjet për reduktimin e emetimeve përmes një mekanizmi që shpërndan dhe tregon lejet (ose lejimet) e emetimeve nëpër firma.⁵ Në praktikë, të dyja qasjet synojnë të njëjtën çështje, duke vënë një çmim karbonit dhe duke reduktuar emetimet në sektorët ndotës.

KARAKTERISTIKAT	TAKSA E KARBONIT	SKEMA E TREGTIMIT TË EMETIMEVE
Siguria e çmimeve	Bizneset janë të sigurt për çmimin e emetimeve të karbonit	Çmimi i emetimeve nuk është çmim konstant i emetimeve të karbonit
Niveli i emetimeve	Niveli i emetimeve ndryshon	Niveli i emetimeve është i qëndrueshëm pasi ekziston një grup kufiri në nivelin e emetimeve
Mënyra e kontrollit	Niveli i karbonit të emetuar caktohet për ton që përkthehet në një taksë për naftën, energjinë elektrike ose gazin natyror.	Kufiri i emetimit është duke ofruar leje për çdo ton dioksid karboni që prodhon.

Figura 4. Emisionet në Kosovë në vitin 2018 për ndotësit kryesorë sipas sektorëve [mg / vit]⁶

⁴ “On The Theory of Externalities” Baumol and Oates, 1988, accessible at shorturl.at/arsCE (accessed in February, 2022)

⁵ United Nations Handbook On Carbon Taxation For Developing Countries, (accessed in February, 2022)

⁶ shorturl.at/pEK4, (accessed in March, 2022)

2.2 TAKSA E KARBONIT

Taksa e karbonit ofron siguri mbi çmimin e emetimeve, por jo mbi nivelin e emetimeve dhe reduktimin e emetimeve të ofruara. Qeveria vendos normën e taksës për ton metrikë të emetimeve ose për njësi të karbonit në lëndët djegëse fosile. Rregullatori nuk ka njohuri të plotë se si një emetues do t'i përgjigjet taksës (p.sh., shkalla që një emetues do të reduktojë emetimet e tij për të ulur detyrimin e tij tatimor) dhe për këtë arsye është sfiduese të dihet niveli që rezulton i reduktimeve të emetimeve. Megjithatë, parashikueshmëria e çmimit të një takse ka përparësi dhe mund të ndihmojë në planifikimin e përcjelljes për investime afatgjata.

Është relativisht e thjeshtë që subjektet e rregulluara të vlerësojnë kostot e tyre të taksës së karbonit (dhe për politikëbërësit të vlerësojnë të ardhurat e mbledhura nga taksat) bazuar në shkallën e taksës dhe profilin e tyre të pritshëm të emetimeve. Taksa e karbonit synon lëndët djegëse fosile si benzina, nafta dhe qymyri i përdorur për prodhimin e energjisë, qëllimet e ngrohjes, si dhe lëndët djegëse motorike. Taksa llogaritet në bazë të sasisë së përlllogaritur të emetimeve të CO₂ të produkteve të mbuluara energjetike që lëshojnë gjatë djegies, masë kjo që bazohet në të ashtuquajturën përmbajtje karboni të lëndëve djegëse fosile. Bizneset mund të llogarisin rritjen e kostos së prodhimit të tyre duke llogaritur sasinë e energjisë që konsumojnë dhe lëndët djegëse fosile që përdorin për të transportuar produktet e tyre, duke u siguruar që të kenë një ide të qartë për kostot që do të vijnë nga taksa e karbonit. Kjo e bën taksën e karbonit një politikë të thjeshtë dhe të kuptueshme për t'u miratuar.

LËNDËT DJEGËSE FOSILE

PËRMBAJTJA E KARBONIT



Tabela 1. Përmbajtja e karbonit në lëndë djegëse të ndryshme fosile ⁷

⁷Forest Research, Carbon Emissions of Different Fuels, accessible at shorturl.at/apIFP, (accessed in March, 2022)

Nga pikëpamja praktike, taksimi i karbonit është një instrument që aplikohet relativisht më lehtë dhe mund të përfitojë nga infrastruktura financiare ekzistuese e pranishme në shumicën e vendeve. Për shembull, një mënyrë për të vendosur taksat e karbonit është aplikimi i një takse mbi lëndët djegëse fosile (p.sh. benzina, nafta, etj.), e cila është në përpjesëtim me përmbajtjen e karbonit në ato lëndë djegëse. Meqenëse shumica e vendeve në botë aplikojnë një lloj tarife ose takse për karburantet, ka shumë të ngjarë që ata të kenë tashmë strukturën e nevojshme administrative për të vendosur një taksë karboni. Një shembull i kësaj forme taksimi është vendi ynë fqinj, Shqipëria, e cila ka vendosur një taksë karboni për karburantet me vlerë 2 lekë për litër.

2.3 SISTEMI I TREGTIMIT TË EMETIMEVE

Një STE ofron siguri mbi sasinë e emetimeve të reduktuara, por jo mbi çmimin e karbonit. Politikëbërësit vendosin kufirin për emetimet dhe çmimi i karbonit do të luhet në varësi të forcave të tregut që përafrojnë ofertën dhe kërkesën e lejuar. Megjithatë, ka veçori të projektimit që lejojnë politikëbërësit të ushtrorjnë një farë mase kontrolli mbi çmimet e karbonit dhe ofertën e lejeve. Këto përfshijnë çmimet e rezervës së ankandeve, dyshemetë e çmimeve ose vendosjen e tarifave shtesë që mund të ndihmojnë në shmangien e çmimeve tepër të ulëta ose të shumë ndihmave në treg.




Figura 5. Skema e Tregimit të Emetimeve të BE-së⁸

⁸shorturl.at/lwJS (accessed in March, 2022)

POLITIKAT E BASHKIMIT EUROPIAN PËR ÇMIMIN NË KARBON

3



Me kalimin e viteve, Bashkimi Evropian ka qenë nënshkrues i marrëveshjeve ndërkombëtare që fokusohen në reduktimin e emetimeve të gazrave serrë të shkaktuara nga faktorë antropologjikë në mbarë botën. Duke filluar me UNFCCC (Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, 1992), Protokollin e Kiotos (1997) dhe Marrëveshjen e Parisit (2015). Edhe pse këto marrëveshje kanë bërë progres në nivel ndërkombëtar, BE-ja ka vendosur politika ambicioze duke nënshkruar Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane në dhjetor 2019.

Qëllimi i Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane është ta bëjë BE-në neutrale ndaj klimës deri në vitin 2050. Për të arritur këtë qëllim, Bashkimi Evropian ka ndërmarrë veprime për të reduktuar emetimet e gazeve serrë nëpërmjet nismave dhe politikave konkrete. Përmes kësaj marrëveshjeje, Bashkimi Evropian dëshiron të bëhet një lider global në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe të vendosë një shembull që vendet e tjera mund të ndjekin. Kosova si një vend që synon të anëtarësohet në Bashkimin Evropian duhet të miratojë politika të brendshme drejt aspiratave evropiane, të cilat aktualisht janë të fokusuara ekskluzivisht në reduktimin e emetimeve të karbonit dhe arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050.

Në dekadat e fundit, BE-ja ka nxjerrë direktiva që synojnë uljen e emetimeve të karbonit, çmimin e karbonit, si dhe efikasitetin e energjisë dhe tranzicionin e energjisë. Këto direktiva u nxorën para dhe pas Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane, gjë që tregon vendosmërinë e BE-së për këtë çështje. Vlen të përmendet Direktiva STE e BE-së, Direktiva për Tatimin e Energjisë dhe Mekanizmi i Rregullimit të Kufirit të Karbonit, të cilat janë të lidhura me çmimin e emetimeve të gazrave serrë.

3.1 SISTEMI I TREGTIMIT TË EMETIMEVE I BE

Të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (duke përfshirë Islandën, Lihtenshtajnin dhe Norvegjinë) janë pjesë e Sistemit të Tregimit të Emetimeve të BE-së, një treg i krijuar për të tregtuar një numër të kufizuar të lejimeve të emetimit të gazeve serrë. Me përjashtim të Zvicrës, Ukrainës dhe Mbretërisë së Bashkuar, të gjitha vendet evropiane që vendosin një taksë karboni janë gjithashtu pjesë e STE të BE-së. Zvicra ka sistemin e saj të tregimit të emetimeve, i cili është i lidhur me STE të BE-së që nga janari 2020. Pas Brexit-it, Mbretëria e Bashkuar zbatoi STE-në e saj që nga janari 2021.⁹ STE e BE-së është një praktikë që synon sektorë shumë ndotës me qëllim që të përshpejtojë procesin e tranzicionit drejt praktikave të pastra dhe të qëndrueshme.

⁹Carbon Taxes in Europe, Elke Asen accessible at shorturl.at/dtT34, (accessed in March, 2022)

STE e BE-së mbulon sektorët dhe gazrat e mëposhtëm, duke u fokusuar në emetimet që mund të maten, raportohen dhe verifikohen me një nivel të lartë saktësie: ¹⁰



Figura 3. Emisionet në Kosovë në vitin 2018 për ndotësit kryesorë sipas sektorëve [mg / vit]¹¹

Pjesëmarrja në STE të BE-së është e detyrueshme për kompanitë në sektorët e lartpërmendur, por

- në disa sektorë, përfshihen vetëm instalimet mbi një madhësi të caktuar,
- disa instalime të vogla mund të përjashtohen nëse qeveritë vendosin masa fiskale ose masa të tjera që do të ulin emetimet e tyre me një sasi ekuivalente,
- në sektorin e aviacionit, deri më 31 dhjetor 2023 STE e BE-së do të zbatohet vetëm për fluturimet ndërmjet aeroporteve të vendosura në Zonën Ekonomike Evropiane.

¹⁰European Commission, Climate Action, EU Action, EU Emission Trading System (EU ETS), accessible at shorturl.at/oCDHY, (accessed in March, 2022)

¹¹shorturl.at/oCDHY, (accessed in March, 2022)

¹²Carbon Taxes in Europe, Elke Asen accessible at shorturl.at/dtT34, (accessed in March, 2022)

ndërmjet aeroporteve të vendosura në Zonën Ekonomike Evropiane.

Por përveç STE të BE-së, vendet evropiane kanë parë nevojën për një tjetër politikë për çmimet e karbonit. Në vitin 1990, Finlanda ishte vendi i parë në botë që vendosi një taksë karboni. Që atëherë, 18 vende evropiane kanë ndjekur, duke zbatuar taksat e karbonit që variojnë nga më pak se 1 € për ton metrikë të emetimeve të karbonit në Poloni dhe Ukrainë, e deri në më shumë se 100 € në Suedi.¹² Taksa e karbonit u zbatua për të mbuluar emetimet e karbonit në sektorë që STE e BE-së nuk i mbulon.

Bashkimi Evropian në korrik 2021 ka miratuar një sërë propozimesh që përcaktojnë objektivat e BE-së për arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050. Një prej këtyre propozimeve përfshin reduktimin e 55% të emetimeve deri në vitin 2030. Për rrjedhojë, Sistemi i Tregtisë së Emetimeve të BE-së është rishikuar me qëllim që të dalin me propozime të reja që lehtësojnë arritjen e këtyre objektivave të rinj. Propozimi i ri, i njohur si EU ETS 2, në janar 2022, propozon përfshirjen e sektorëve të transportit dhe ekonomive shtëpiake në sistemin e çmimeve të karbonit. Propozimet e reja përfshijnë edhe Fondin e Klimës Sociale, i cili synon të adresojë çdo ndikim social që rrjedh nga ky sistem i ri.

3.2 DIREKTIVA E TAKSIMIT TË ENERGJISË

Direktiva për Tatimin e Energjisë (2003/96/EC), e njohur zakonisht si ETD, është korniza e Bashkimit Evropian për taksimin e produkteve energjetike, duke përfshirë energjinë elektrike, motorin dhe shumicën e karburanteve për ngrohje. Përveç përcaktimit të rregullave strukturore për të shmangur shtrembërimet e mundshme të konkurrencës në të gjithë BE-në, ETD përcakton normat minimale të akcizës me synimin për të inkurajuar një ekonomi me karbon të ulët dhe me efikasitet energjie. Shtetet anëtare hartojnë taksat e tyre brenda kornizës së ETD dhe mund të përcaktojnë normat e brendshme nëse përmbushin minimumin e ETD.¹³ Në vitin 2021, kjo direktivë u rishikua me qëllim për të përafuar ETD me objektivat 2030 dhe 2050, si pjesë e Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane.

¹³KPMG, Home, Insights, Energy Taxation Directive, accessible at shorturl.at/mswKR, (accessed in March, 2022)

¹⁴Carbon Market Watch, Home, News and Press, A brief explanation of the Carbon Border Adjustment Mechanisms (CBAM), accessible at shorturl.at/entJK, (accessed in March, 2022)

¹⁵European Commission, Home, Press Corner, Carbon Border Adjustment Mechanism, accessible at shorturl.at/gD458, (accessed in March, 2022)



3.3 MEKANIZMI I RREGULLIMIT KUFITAR TË KARBONIT

Sipas propozimit të Komisionit Evropian, një Mekanizëm i Rregullimit të Kufirit të Karbonit (CBAM) do të kontribuonte në arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050. Ai do të funksiononte krahas mjeteve të tjera të politikës në paketën 'Fit for 55' duke adresuar rreziqet e të ashtuquajturave rrjedhjet e karbonit që vijnë nga ambicia e rritur e BE-së për klimë. Rrjedhja e karbonit është situata hipotetike ku prodhuesit evropianë që konkurrojnë në tregjet ndërkombëtare do ta zhvendosnin prodhimin dhe ndotjen e tyre në vende me politika më pak të rrepta ose pa politika klimatike për të ulur kostot e tyre të pajtueshmërisë.

CBAM do të bëhet në mënyrë progresive një alternativë ndaj masave aktuale të mbrojtjes nga rrjedhjet e karbonit, veçanërisht shpërndarjen falas të lejimeve të emetimeve sipas Sistemit të Tregtimit të Emisioneve të BE-së (STE). Siguron një çmim ekuivalent të karbonit për prodhimin vendas dhe të importuar të mallrave të përzgjedhura. Në këtë mënyrë, do të inkurajonte edhe partnerët tregtarë të reduktonin emetimet e tyre.¹⁴ CBAM do të futet gradualisht dhe fillimisht do të zbatohet vetëm për një numër të përzgjedhur mallrash me rrezik të lartë të rrjedhjes së karbonit, si: hekuri dhe çeliku, çimentoja, plehrat, alumini dhe prodhimi i energjisë elektrike.

I projektuar në përputhje me rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare të BE-së, sistemi CBAM do të funksionojë si më poshtë: Importuesit e BE-së do të blejnë certifikata karboni që korrespondojnë me çmimin e karbonit që do të ishte paguar, nëse mallrat do të ishin prodhuar sipas rregullave të BE-së për çmimin e karbonit. Në të kundërt, sapo një prodhues jashtë BE-së mund të tregojë se ata kanë paguar tashmë një çmim për karbonin e përdorur në prodhimin e mallrave të importuara në një vend të tretë, kostoja përkatëse mund të zbritet plotësisht nga importuesi i BE-së.¹⁵ Kjo politikë do të sjellë mundësi të barabarta për prodhuesit vendas dhe ndërkombëtarë dhe gjithashtu do të synojë sasi më të mëdha të emetimeve të karbonit në mbarë botën.

Një sistem raportimi do të zbatohet nga viti 2023 për ato produkte me objektivin e lehtësimit të një prezantimi të qetë dhe lehtësimit të dialogut me vendet e treta, dhe importuesit do të fillojnë të paguajnë një rregullim financiar në vitin 2026. Pasi sistemi përfundimtar të bëhet plotësisht funksional në vitin 2026, importuesit e BE-së do të duhet të deklarojnë çdo vit sasinë e mallrave dhe numrin e emetimeve të përfshira në totalin e mallrave që ata kanë importuar në BE në vitin e mëparshëm dhe të dorëzojnë sasinë përkatëse të certifikatave CBAM. Emetimet e integruara përfshijnë emetimet totale të karbonit të çliruara në procesin e nxjerrjes së një produkti në treg, nga fillimi në fund.

¹³KPMG, Home, Insights, Energy Taxation Directive, accessible at shorturl.at/mswKR, (accessed in March, 2022)

¹⁴Carbon Market Watch, Home, News and Press, A brief explanation of the Carbon Border Adjustment Mechanisms (CBAM), accessible at shorturl.at/entJK, (accessed in March, 2022)

¹⁵European Commission, Home, Press Corner, Carbon Border Adjustment Mechanism, accessible at shorturl.at/gD458, (accessed in March, 2022)

IMPLEMENTIMI I TAKSËS SË KARBONIT

4



Kosova si një vend në zhvillim që synon të jetë pjesë e Bashkimit Evropian, në rrugën e saj drejt integritimit ka përshtatur politikat dhe strategjitë kombëtare për t'iu përshtatur prioritetëve evropiane. Si palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Kosova ka obligim të zbatojë *acquis* në fuqi për energjinë.¹⁷ Traktati dhe *acquis* e tij evoluojnë vazhdimisht për të përfshirë sektorë të rinj, si dhe për të përditësuar ose zëvendësuar aktet më të vjetra.¹⁸ Për secilën dispozitë kyçe të *acquis* të Komunitetit të Energjisë, Kosova ka zbatuar akte ligjore për të përshtatur rekomandimet e Komisionit të BE-së. Këto dispozita përfshijnë kalimin në burimet e rinovueshme të energjisë dhe aktet për ndryshimet klimatike, të cilat të dyja mund të lehtësohen nga një politikë e çmimeve të karbonit.

Bashkimi Evropian ka zbatuar Sistemin e Tregtimit të Emisioneve të BE-së që nga viti 2003. Ky sistem synon emetimet e karbonit të emetuara nga sektori i energjisë. Vendet anëtare të BE-së gjithashtu kanë futur taksën e karbonit në vendet e tyre përkatëse si një detyrim për sektorët që nuk mbulohen nga STE e BE-së. Një mekanizëm tjetër që do të zbatohet në vitet e ardhshme është Mekanizmi i Rregullimit të Kufirit të Karbonit (CBAM), i cili do të rregullojë çështjen e rrjedhjes së karbonit, për të barazuar kushtet e tregut për prodhuesit vendas dhe importuesit nga vendet që nuk kanë çmimin e karbonit. Kjo politikë do të prekë prodhuesit e Kosovës, prandaj vendi ynë duhet t'i paraprijë këtij mekanizmi duke miratuar një formë të çmimit të karbonit para vitit 2026 kur ky mekanizëm të hyjë në fuqi.

Çmimi i karbonit mund të prezantohet në forma të ndryshme, varësisht se cili është më i përshtatshëm për vendin. Çmimi i qartë i karbonit zbatohet në dy mënyra të ndryshme: si një taksë mjedisore ose një taksë karboni. Çmimet e qarta të karbonit sjellin pagesa të transfertave ndaj shtetit, duke imponuar një barrë financiare për konsumatorin, si dhe kosto shtesë të rregullimit për kompaninë që emeton. Çmimi i nënkuptuar i karbonit i cili përdoret në STE të BE-së mund të aplikohet si çmimi i një çertifikate të lejitimit të emetimit të gazrave serrë. Një autoritet qendror lëshon lejet, duke shërbyer për të justifikuar emetimet e gazrave serrë. Instalimi i shkarkimit duhet të zotërojë lejet përkatëse për të justifikuar emetimet, përndryshe zbatohet një gjobë.¹⁹ Studimet kanë treguar se taksat e karbonit është ndër instrumentet më efikase të politikave në dispozicion për të zbutur ndryshimet klimatike.²⁰ Taksat e karbonit është lehtësisht e zbatueshme për vendet në zhvillim pasi mund të bazohet në politikat tatimore të zbatuara më parë.

¹⁷Energy Community, Home, Implementation, Kosovo, accessible at shorturl.at/dowKN, (accessed in April, 2022)

¹⁸Energy Community, Home, Legal, Energy Community *acquis*, accessible at shorturl.at/dzQ04, (accessed in April, 2022)

¹⁹A carbon pricing design for the Energy Community Final Report, (accessed in April, 2022)

²⁰Partnership for Market Readiness (PMR) 2017. Carbon Tax Guide: A Handbook for Policy Makers. World Bank, Washington, DC. License: Creative Commons Attribution CC BY 3.0 IGO, (accessed in March, 2022)



Figura 6. Forma të ndryshme të taksimit të karbonit ²¹

Taksa e karbonit vendos një çmim për emetimet dhe i takon agjentëve ekonomikë të vendosin se sa të emetojnë (bazuar në shumën totale që ata janë të gatshëm të shpenzojnë). Prandaj, nuk ka siguri që çdo nivel i caktuar tatimor do të rezultojë në reduktimin e dëshiruar të emetimeve të gazeve serrë. Kufizimi i taksës së karbonit (d.m.th., mungesa e një tregu karboni që lejon blerjen e lejeve, të cilat mund të jenë më të lira se reduktimi i emetimeve) mund të kapërcehet duke përdorur mekanizma të tillë si kompensimet, d.m.th., duke lejuar aktorët ekonomikë të paguajnë për një shumë ekuivalente emetimet të reduktohen ose të “përthithen” diku tjetër në vend që të paguajnë taksën. Një shembull mund të jetë që një termocentral në Kanada paguan një fermer në Zambia për të mbjellë një sasi pemësh të mjaftueshme për të kompensuar emetimet e termocentralit. Kjo mund të jetë më e lirë se pagimi i taksës ose investimi i konsiderueshëm i kërkuar për ndërrimin e karburanteve dhe mund të ketë bashkëpërfitime të konsiderueshme (për shembull, mbi jetesën e njerëzve në vendet në zhvillim).²² Kompensimet ose përjashtimet nga pagesa direkte e tatimit duhet të reduktohen me kalimin e kohës në mënyrë që vlerësimi i arritjes së objektivit të jetë më i saktë.

²¹ shorturl.at/elzV5, (accessed in April, 2022)

²² United Nations Handbook On Carbon Taxation For Developing Countries, (accessed in March, 2022)

²³ This is an adaptation of an original work by The World Bank. Views and opinions expressed in the adaptation are the sole responsibility of the author or authors of the adaptation and are not endorsed by The World Bank. (accessed in March, 2022)

Megenëse ndikimet e taksës mund të jenë të vështira për t'u parashikuar paraprakisht, zbatimi i taksës së karbonit duhet të shihet si një proces mësimi. Nëse qëllimi i dëshiruar i politikës nuk arrihet pas një periudhe të caktuar, duhet të pasojë një rregullim tatimor.²³ Preferohet që pas një periudhe të caktuar kohore të rishikohen objektivat për reduktimin e emetimeve dhe zgjerimin e mbulimit të sektorëve në mënyrë që taksa e karbonit të arrijë të gjithë sektorët ndotës.

Politikëbërësit duhet të marrin në konsideratë jo vetëm se si të arrijnë dizajnin më të mirë teknik, por edhe si të sigurojnë pranueshmërinë e publikut. Prandaj, qeveritë e interesuara për zbatimin e taksave të karbonit duhet të marrin në konsideratë strategjitë për të arritur pranueshmërinë e menjëhershme dhe pranimin e përhershëm. Pranueshmëria e ulët ka qenë një problem në përpjekjet e dështuara për të zbatuar taksat e karbonit, për shembull, në shtetin e Uashingtonit (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), ku një iniciativë votimi për një taksë karboni u refuzua si në vitin 2016 ashtu edhe në vitin 2018. Në mënyrë të ngjashme, në Francë, protestat e jelekëve të verdhë në 2018 detyruan qeverinë të pezullojë propozimin e saj për të përshkallëzuar taksën ekzistuese të karbonit.²⁴ Prandaj, futja e një takse për karbonin duhet të vijë me një dizajn kreativ që do të sigurojë pranueshmërinë e publikut duke marrë parasysh administratën tatimore, normën tatimore dhe taksapaguesit.




Figura 7. Produkti i brendshëm bruto për kokë banori në dollarë amerikanë dhe adoptimi i çmimit të karbonit në 20 demokraci të pasura
Shënim: Pikat tregojnë vitin e zbatimit të çmimit të karbonit sipas vendit.²⁵

²⁴United Nations Handbook On Carbon Taxation For Developing Countries, (accessed in February, 2022)

²⁵World Bank Carbon Pricing Dashboard and Organisation for Economic Co-operation and Development

4.1 TAKSAPAGUESIT

Secili shtet anëtar i BE-së ka diskrecion se ku duhet tatimi në zinxhirin e shpërndarjes dhe ka fleksibilitet në përcaktimin e masës së regjimit të pezullimit të taksave. Disa vende të BE-së po zbatojnë rregulla të cilat rezultojnë në relativisht pak taksapagues. Tatimpaguesit e tillë zakonisht gjenden në fillim të zinxhirit të shpërndarjes, ndërsa operatorët më poshtë zinxhirit të shpërndarjes nuk do të përfshihen në mbledhjen e taksave. Ndërsa disa vende të BE-së, si Suedia, lejojnë që konsumatorët e bizneseve të mëdha të jenë tatimpagues, legjislacioni i BE-së nuk i lejon individët privatë të regjistrohen si tatimpagues. Kjo do të thotë që stacionet e benzinës, për shembull, që shesin lëndë djegëse, nuk janë tatimpagues, por blejnë karburantet tashmë të tatuara në një pjesë të mëparshme të zinxhirit të shpërndarjes.²⁶ Kjo siguron që barra tatimore të mos bjerë mbi familjet që nuk kanë alternativë tjetër veç përdorimit të produkteve me intensitet karboni.




Figura 8. Kategorizimi i përgjithshëm i pikave të mundshme të rregullimit për lëndët djegëse fosile²⁷

²⁶United Nations Handbook on Carbon Taxation For Developing Countries, (accessed in March, 2022)

²⁷Carbon Tax Guide: A Handbook for Policy Makers. World Bank, Washington, DC. License: Creative Commons Attribution CC BY 3.0 IGO, (accessed in April, 2022)

Sipas draftit të Strategjisë së Energjisë 2022-2031, taksa e karbonit në Kosovë do të zbatohet nga viti 2025 dhe do ta taksojë Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK). Kështu, bizneset dhe qytetarët nuk do të preken nga kjo taksë nga viti 2025. Mirëpo, Kosova me nënshkrimin e Deklaratës së Sofjes është zotuar për dekarbonizimin e plotë deri në vitin 2050, që do të thotë padyshim që taksa e karbonit do të zgjerohet edhe në sektorë të tjerë në të ardhmen. Industritë ndotëse si përpunimi i metaleve tashmë kanë filluar të investojnë në teknologjitë e gjelbra në mënyrë që kur tatimi i karbonit të bëhet realitet në Kosovë ose kur BE-ja t'i taksojë ato për eksportet e tyre, ato të vazhdojnë të jenë konkurruese në tregjet ndërkombëtare.

ÇFAR TË TATOHET?

Qasja e karburantit	Qasja e Emetimeve Direkte
Taksa mbi vëllimin ose njësitë e peshës së karburanteve që shkaktojnë emetime kur digjen	Taksa mbi emetimet direkt në burim

Table 3. Qasje të ndryshme tatimore²⁸

4.2 NORMAT E TAKSIMIT

Normat e taksës së karbonit janë të ndryshme në të gjitha vendet ku zbatohet. Vlen të përmendet se juridiksionet që kanë normat më të larta në fuqi nuk i kanë nisur programet e tyre të taksave të karbonit në një nivel të lartë. Shumica e juridiksioneve (për shembull, Suedia) filluan programet e tyre të taksave të karbonit me norma tatimore relativisht të ulëta, duke i rritur ato për një periudhë të gjatë. Megjithatë, shumica e iniciativave aktualisht zbatojnë norma tatimore relativisht të ulëta të karbonit, përgjithësisht nën 30 USD / tCO₂e.²⁹ Idealisht, Kosova duhet të paraqesë një normë të ulët të taksës së karbonit, por duhet të angazhohet që ta rrisë këtë normë në mënyrë progresive për të përmbushur normat e BE-së brenda një periudhe të caktuar kohore. Sipas draftit të Strategjisë së Energjisë dhe po ashtu sikurse edhe parashikimeve të Komunitetit të Energjisë, shkalla e tatimit në Kosovë do të prezantohet në vitin 2025 në 15% të vlerës së normës së BE-së, pastaj do të rritet çdo 5 vjet deri në vitin 2050, kur do të arrijë 100% të normës së BE-së.

²⁸United Nations Handbook On Carbon Taxation For Developing Countries, (accessed in March, 2022)


²⁹United Nations Handbook On Carbon Taxation For Developing Countries Price, (accessed in March, 2022)

³⁰Tax Foundation, accessible at shorturl.at/lnKPY, (accessed in March, 2022)

Vendet e zhvilluara si Suedia, Lihtenshtajni, Zvicra dhe Finlanda janë vendet që vendosin taksat më të larta të karbonit. Normat më të ulëta të taksës së karbonit janë në Poloni, Ukrainë dhe Estoni. Me përjashtim të Zvicrës, Ukrainës dhe Mbretërisë së Bashkuar, të gjitha vendet evropiane që vendosin një taksë karboni janë gjithashtu pjesë e STE të BE-së. Zvicra ka sistemin e saj të tregtimit të emetimeve, i cili është i lidhur me STE të BE-së që nga janari 2020. Pas Brexit-it, MB zbatoi STE-në e saj në MB që nga janari 2021.³⁰ Është e dukshme se vendet që ende varen nga lëndët djegëse fosile si burimet kryesore të energjisë mbajnë një normë tatimore relativisht të ulët.

Carbon Taxes in Europe

Carbon Tax Rates per Metric Ton of CO₂e, as of April 1, 2021



Note: The carbon tax rates were converted using the EUR-USD currency conversion rate as of April 1, 2021.
Source: World Bank, "Carbon Pricing Dashboard."

Figura 9. Taksat e karbonit në Europë³¹

³¹ shorturl.at/juwJS, (accessed in April, 2022)

³² Eurostat, Statistics Explained, Glossary: Carbon Dioxide Equivalent, accessible at shorturl.at/rILOY, (accessed in March, 2022)

Emetimet e gazeve serrë llogariten përmes ekuivalentit të dioksidit të karbonit. Një ekuivalent i dioksidit të karbonit ose ekuivalenti i CO₂ është një masë metrike e përdorur për të krahasuar emetimet nga gazet e ndryshme serrë në bazë të potencialit të tyre të ngrohjes globale (GWP), duke konvertuar sasi të gazrave të tjerë në sasinë ekuivalente të dioksidit të karbonit me të njëjtin potencial ngrohjeje. Për shembull, GWP për metanin (CO) është 25 dhe për oksidin e azotit (N₂O) është 298. Kjo do të thotë se emetimet prej 1 milion ton metrikë metan dhe oksid azoti përkatësisht janë ekuivalente me emetimet prej 25 dhe 298 milion ton metrikë dioksid karboni.³² Meqenëse ZRRE në Kosovë raporton çdo vit emetimet nga të gjitha gazet serrë, emetimet nga secili ndotës mund të maten dhe tatimi do të jetë më i saktë.

SHEMBUJ TË FAKTORËVE TË EMETIMIT DHE VLERAVE TË NGROHJES PËR LËNDËT DJEGËSE TË ZAKONSHME FOSILE

	Faktori i emetimit* (kg CO ₂ per GJ)	Heating value **	Emetimet nga djegia ***
Benzine	73	33 GJ per m ³	2409 kg per m ³
Vaj nafte	74	37 GJ per m ³	2738 kg per m ³
Gaz i lëngshëm i naftës (LPG)	63	24 GJ per m ³	1512 kg per m ³
Naftë	77	40 GJ per m ³	3080 kg per m ³
Qymyr (antracit)	98	30 GJ per tonne	2940 kg per tonne
Gaz natyrorë	56	38 GJ per m ³	2128 kg per 1000 m ³

Tabela 4. Shembuj të faktorëve të emetimit dhe vlerave të ngrohjes për lëndët djegëse të zakonshme fosile³³

³³United Nations Handbook On Carbon Taxation For Developing Countries Price, (accessed in March, 2022)

TPP A		2019			
Muaji	Realizuar bruto prodhimi i EE [Mwn]	Qymyri i konsumuar [t]	SO [kg] Mesatare 1686 [kg/MWh]	NOx [kg] Mesatare 3167 [kg/MWh]	CO [kg] Mesatare 1180 [kg/MWh]
Janar	183 282	278 588	309 013	580 454	216 272 545
Shkurt	163 644	248 740	275 905	518 262	193 100 486
Mars	196 373	298 488	331 086	621 914	231 720 584
Pril	170 190	258 689	286 941	538 993	200 824 506
Maj	173 463	263 664	292 459	549 358	204 686 516
Qershor	176 736	268 639	297 977	559 723	208 548 525
Korrik	176 736	268 639	297 977	559 723	208 548 525
Gusht	176 736	268 639	297 977	559 723	208 548 525
Shtator	170 190	268 689	286 941	538 993	200 824 506
Tetor	176 736	268 639	297 977	559 723	208 548 525
Nentor	170 190	268 689	286 941	538 993	200 824 506
Dhjetor	176 736	268 639	297 977	559 723	208 548 525
